



Shkruan: Hajdin ABAZI



KQZ-ja PRANON SERVERË DHE PAJISJE PËRCJELLËSE PËR QNR-në, BËHET THIRRJE QË QYTETARËT TË VOTOJNË MË 9 SHKURT



Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka organizuar të mërkurën ceremoninë e pranimit të serverëve dhe pajisjeve përcjellëse për këtë qendër, donacion nga qeveria

gjermane përmes OSBE-së. Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka bërë thirrje për proces të qetë zgjedhor, derisa i ka ftuar qytetarët të dalin në

votime në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt. Ndërkaq Këshilli Prokurorial i Kosovës ka njoftuar për angazhimin e 100 prokurorëve për ditën e zgjedhjeve

**KOSOVË, SFIDAT
E QEVERISË SË
ARDHSHME PAS
ZGJEDHJEVE TË
9 SHKURTIT NË
MARRËDHËNIET ME
ALEATËT E SAJ**



**POLICIA E KOSOVËS VË
NË PRANGA TË DYSHUARIN
QË KOMPROMETOI MBI 300
MIJË KARTELA BANKARE
NË NJË SHTET TË BE-së**



**ADMINISTRATA TRUMP PEZULLON
NGA PUNA PUNONJËSIT E USAID-IT
NË MBARË BOTËN**

**OSMANI NË UASHINGTON,
PRESIDENCA: ËSHTË FTUAR NË
LUTJET E MËNGJESIT, DO TË TAKOHET
ME ZYRTARË TË ADMINISTRATËS
AMERIKANE DHE KONGRESISTË**

**SHOQATA E DISTRIBUTORËVE
KËRKON SHTYRJEN E AFATIT
PËR ÇMIMET E BARNAVE DHE
MBROJTJEN E STOQVE AKTUALE**



EKONOMI

**MODIFIKOHET FORMULARI
"WR" PËR TATIMET
E MBAJTURA NË BURIM**

**ISMAILI TAKON EKSPERTËT E
MISIONIT TË BANKËS BOTËRORE,
FLASIN PËR PROJEKTIN MË TË RI
PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT
FINANCIAR**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Administrata Trump pezullon nga puna punonjësit e USAID-it në mbarë botën

WASHINGTON, 5 SHKURT - Administrata e presidentit amerikan Donald Trump njoftoi se do t'i pezullojë nga puna të gjithë punonjësit me kontratë të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në mbarë botën dhe se do t'i tërheqë mijëra pjesëtarë të stafit që punojnë jashtë vendit.

“Të premten, më 7 shkurt, të gjithë punonjësit me kontratë të USAID-it do të pezullohen në gjithë botën”, thuhet në një njoftim në uebsajtin e USAID-it, i cili ka qenë jashtë funksionit që prej fundjavës së kaluar.

Forca punëtore e USAID-it numëron më shumë se 10 000 persona. Rreth dy e treta e stafit shërben jashtë vendit, sipas Shërbimit Kërkimor të Kongresit (CRS). Agjencia ka më shumë se 60 misione kombëtare dhe rajonale.

USAID-i është i pranishëm në Kosovë që prej vitit 1999, e prej atëherë ka investuar më shumë se 1 miliard dollarë në zhvillimin e Kosovës.

Përgjatë 25 vjetëve USAID-i ka zhvilluar programe për luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, luftën kundër dezinformimit dhe avokimin e medieve të pavarura,

forcimin e shoqërisë civile dhe demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Për stafin e USAID-it jashtë vendit, Uashingtoni është duke e përgatitur një plan në koordinim me Departamentin e Shtetit dhe do t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit të personelit për t'u kthyer në Shtetet e Bashkuara brenda 30 ditësh, thuhet në njoftim.

Udhëheqësia e USAID-it do ta shqyrtojë bërjen e përjashtimeve bazuar në vështirësitë personale ose shqetësimet mbi lëvizshmërinë dhe sigurinë, sipas njoftimit.

Në njoftim u theksua se personeli thelbësor që pritet ta vazhdojë punën do të njoftohet nga udhëheqësia e agjencisë deri të enjten, më 6 shkurt.

“Faleminderit për shërbimin tuaj”, u tha në fund të njoftimit.

Presidenti Trump synon ta bashkojë USAID-in, agjencinë kryesore humanitare të Uashingtonit që ndan miliarda dollarë ndihma jashtë vendit, me Departamentin e Shtetit, si dhe ta shpërbëjë atë si ent të pavarur.

Të hënën sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, u tha gazetarëve se ai tani është administrator në detyrë i USAID-



it, duke theksuar se kjo agjenci "nuk përgjigjet fare" dhe duke e akuzuar stafin atje se është "i papërgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve të thjeshta" në lidhje me programet.

Ai e njoftoi Kongresin në një letër për riorganizimin e agjencisë, duke thënë se disa pjesë të USAID-it mund t'i bashkohen Departamentit të Shtetit, ndërsa pjesët e mbetur mund të zhbëhen.

Por, meqenëse Kongresi e themeloi USAID-in si një institucion të pavarur brenda degës ekzekutive, presidenti nuk

e ka autoritetin ta shfuqizojë atë pa autorizimin e Kongresit, sipas një raporti të CRS-së këtë javë.

Qindra programe të USAID-it, që ofrojnë ndihmë jetike në mbarë botën, u ndalën pasi Trumpi, më 20 janar, urdhëroi ngrirjen e shumicës së ndihmës amerikane, duke thënë se ai dëshiron të sigurohet që ajo të jetë në përputhje me politikën e tij të jashtme.

Ai e ngarkoi miliarderin Elon Musk, i cili pretendoi se USAID-i është organizatë "kriminale", me detyrën për ta tkurrur agjencinë.

Në vitin fiskal 2023 Shtetet e

Bashkuara i ndanë 72 miliardë dollarë ndihmë në mbarë botën për shumëçka, nga shëndeti i grave në zonat e konfliktit, te qasja në ujë të pastër, trajtimet për HIV/AIDS, siguria energjetike dhe puna kundër korrupsionit.

Financimi, më pak se 1 % e buxhetit total të Shteteve të Bashkuara, është thelbësor për përpjekjet e Uashingtonit për të ndërtuar aleanca në mbarë botën, për ta forcuar diplomacinë e tij dhe për ta kundërshtuar ndikimin e kundërshtarëve si Kina dhe Rusia në vendet në zhvillim.

Trumpi propozon largimin e palestinezëve nga Gaza për t'i hapur rrugë “pronësisë” amerikane

WASHINGTON, 5 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, shpalli më 4 shkurt një propozim, sipas të cilit, palestinezët e zhvendosur do të largoheshin nga Rripi i Gazës, duke i hapur rrugën ShBA-së për ta marrë në pronësi këtë territor bregdetar dhe për ta zhvilluar ekonomikisht në një vend “fenomenal”, ku kombësi të ndryshme mund të jetojnë në paqe.

Trumpi tha se kjo do të ndodhte pas zhvendosjes së popullit palestinez në vende të tjera, për t'i larguar nga ajo që ai e quajti “gropë ferri” me ndërtesa të shkatërruara, pas më shumë se një viti luftë mes Izraelit dhe Hamasit, të cilin ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian e kanë shpallur organizatë terroriste.

Trumpi e bëri këtë propozim në një konferencë të përbashkët me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, duke thënë se një hap kaq drastik është i nevojshëm, sepse idetë e tjera për t'i dhënë fund konfliktit dekadash mes palestinezëve dhe izraelitëve nuk kanë funksionuar.

Propozimi i tij për Gazën do të nënkuptonte se ShBA-ja do ta ketë atë nën kontroll, si dhe do ta përmbyste politikën amerikane afatgjatë që mbështeste zgjidhjen me dy shtete për konfliktin



izraelit-palestinez.

Trumpi tha se ShBA-ja do të punojë për çmontimin e të gjitha bombave të pashpërthyer dhe armëve të tjera në këtë territor, si dhe për pastrimin e ndërtesave të shkatërruara, para se ta zhvillojë ekonomikisht zonën.

“Nëse është e nevojshme, ne do ta bëjmë këtë. Do ta marrim atë pjesë, do ta zhvillojmë, do të krijojmë mijëra e mijëra vende pune dhe do të jetë diçka për të cilën e gjithë Lindja e Mesme mund të ndihet krenare”, tha Trumpi.

Presidenti nuk dha menjëherë hollësi mbi vendet ku

palestinezët do të zhvendoseshin, por tha se do ta mbështeste vendosjen e tyre “në mënyrë të përhershme” në shtete të tjera.

Më herët gjatë ditës, ai përsëriti thirrjen e tij që Jordania, Egjipti dhe shtetet e tjera arabe t'i pranojnë palestinezët nga Gaza.

Hamasit ka këmbëngulur se dëshiron të mbetet në Gazë.

Zyrtari i lartë i Hamasit, Sami Abu Zuhri, e dënoi më herët thirrjen e Trumpit për largimin e palestinezëve si një “dëbim nga toka e tyre”.

Në një deklaratë të lëshuar pas njoftimit të Trumpit, Hamasit e

hodhi poshtë idenë që palestinezët duhet të largohen nga territori.

“Në vend që të mbahet përgjegjës pushtimi i shtetit për krimet e gjenocidit dhe dëbimin, ai po shpërblehet, nuk po ndëshkohet”, tha Hamasit.

“Ne i refuzojmë deklaratat e Trumpit, në të cilat ai thotë se banorët e Gazës nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të largohen, dhe i konsiderojmë ato një recetë për krijimin e kaosit dhe tensioneve në rajon”.

Ministria e Jashtme saudite lëshoi një deklaratë ku theksoi se mbështetja e saj për krijimin e

një shteti të pavarur palestinez është një “qëndrim i palëkundur, i qëndrueshëm dhe i patundur”.

Sipas deklaratës, princi i kurorës, Mohammed bin Salman, sundimtari de facto i Arabisë Saudite, ka thënë se vendi i tij nuk do t'i ndalojë përpjekjet për krijimin e një shteti të pavarur palestinez me Jerusalemin Lindor si kryeqytet.

Trumpi tha se e kishte diskutuar propozimin e tij me Netanyahu gjatë takimit të tyre në Shtëpinë e Bardhë.

Ai tha se e kishte ngritur këtë çështje me liderë të tjerë të vendeve të Lindjes së Mesme dhe pretendoi se ishte pritur pozitivisht.

Netanyahu tha se Trumpi sheh një të ardhme ndryshe për Rripin e Gazës, të cilin ai e përshkroi si burimin e shumë “vuajtjeve dhe fatkeqësive” për popullin izraelit.

“Ai ka një ide të ndryshme”, tha Netanyahu.

“Është diçka që mund ta ndryshojë historinë dhe ia vlen ta ndjekim këtë rrugë”.

Vetëm dy javë pas fillimit të mandatit të tij të dytë, Trump priti Netanyahu për të diskutuar për të ardhmen e armëpushimit në Gaza, lirin e pengjeve dhe një përpjekje të re për një marrëveshje normalizimi në mes të Izraelit dhe Arabisë Saudite.

Kosovë, sfidat e qeverisë së ardhshme pas zgjedhjeve të 9 shkurtit në marrëdhëniet me aleatët e saj

PRISHTINË, 5 SHKURT - Partitë politike në Kosovë po vijnë fushatën për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, mes debatesh për problemet e trashëguara dhe ndarjet e thella rreth shumë çështjeve që lidhen me politikat e brendshme dhe të jashtme.

Analistët thonë se kësaj radhe qeveria e ardhshme e vendit do të përballlet me sfida shumë më të rënda në një botë shumë më të paparashikueshme.

Engjëllushe Morina nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare thotë për “Zërin e Amerikës” se zgjedhjet e fundit në Evropë dhe Amerikë e kanë ndryshuar kontekstin gjeostrategjik në shumë aspekte dhe për këtë arsye Kosovën e presin sfida të mëdha në vitet e ardhshme. “Kështu që cilado qeveri që del prej zgjedhjeve të dielës besoj se do të duhet të ketë një fokusim të veçantë sidomos në pozitën e Kosovës në rajonin e Ballkanit, po ashtu edhe për pozitën e Kosovës në integritet e saj euroatlantike edhe pse këto integritet për momentin janë vënë në pikëpyetje për shkak të qeverisë së re në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, presidenti i së cilës insiston që të zvogëlohet influenca e ShBA-së në Evropë sidomos në sferën e sigurisë. Do të thotë të gjitha këto paraqesin sfida të mëdha për të cilat Kosova vërtet duhet me qenë e përgatitur që të ballafaqohet me to”, tha ajo.

Besar Gërgi nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike thotë se kushdo që do të themelojë qeverinë pas 9 shkurtit duhet ta ndryshojë rrugën aktuale të politikës së jashtme ose të punojë për një shpjegim më të mirë të realiteteve në terren. “Cilado qeveri që vjen do të duhet të zgjedhë njërin nga këto dyja, ose të vazhdojë me një politikë

sa më të butë sa i përket fqinjit tonë verior ose duhet të investojë më shumë në diplomaci dhe komunikim me aleatët në mënyrë që të mos ketë hapësirë për keqkuptime”, tha Gërgi.

Që nga qershori i vitit 2023 Kosova është nën masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian për shkak të veprimeve të saj në veriun e banuar me shumicë serbe. Edhe zyrtarë të lartë amerikanë të administratës së ish-presidentit Joe Biden kishin paralajmëruar në disa raste për përkeqësim të marrëdhënieve në mes dy vendeve për shkak të veprimeve të pabashkërenduara të Qeverisë së Kosovës.

Përfaqësuesit e partive opozitare në Kosovë thonë se vendi që nga shpallja e pavarësisë asnjëherë nuk ka qenë në një pozicion më të pavoritshëm me partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e programit të tyre janë edhe riparimi dhe thellimi i marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara që, sipas tyre, janë thelbësorë për të ardhmen e Kosovës. “Kosova shtet i pavarur e sovran, i anëtarësuar në NATO dhe Bashkim Evropian, me miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdon të jetë misioni politik edhe sot”, tha kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku.

Ndërkaq kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka thënë se do ta forcojnë aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendet demokratike të botës.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidat për kryeministër, Ramush Haradinaj, ka theksuar se duhet hequr mashtruesin sepse, siç thotë ai, “duam siguri,



siguri të plotë dhe duam siguri të përgjithshme”. “Duam anëtarësim në NATO dhe duam anëtarësim me planin nacional. Duam miqësi me Amerikën, prandaj duhet hequr mashtruesin”, tha Haradinaj.

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, që mban aktualisht këtë post, gjatë shpalljes së zotimeve të tij tha se do të forcojë edhe më tej marrëdhëniet strategjike të vendit me partnerët ndërkombëtarë. Por, gjatë një tubimi në Mitrovicë, Kurti tha se nuk do ta themelojë Asociacionin e Komunave Serbe, një kërkesë kjo e vazhdueshme e diplomatëve perëndimorë. “Republika e Kosovës me qeverinë tonë në udhëheqje i thotë jo kurrë ‘Zajednicës’ dhe po Asociacionit të Komunave të Kosovës, ku tash e kemi edhe komunën veriore të Mitrovicës sonë të dashur”, tha Kurti.

I dërguari i posaçëm i presidentit Donald Trump për misionet të veçanta, Richard Grenell, tha se qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti nuk është e besueshme. Në

një postim në rrjetet sociale ai tha se “retorika e përdorur nga (Albin) Kurti tani, duke pretenduar se është i afërt me ShBA-në dhe më mirë se të gjitha qeveritë e tjera të Kosovës, është absolutisht e rreme. Mos u mashtroni”, shkroi ai.

“Zëri i Amerikës” i kërkoi zyrës së kryeministrit Kurti një koment për deklaratat e Grenellit, por deri në përgatitjen e këtij materiali nuk mori përgjigje. “Kjo deklaratë ishte mjaft e pazakonshme sa i përket një zyrtari të lartë amerikan në një periudhë para zgjedhore, mund të jetë ndoshta edhe një kërkesë për t’u bërë aktorë në zgjedhjet në Kosovë, por se duhet të jetë mjaft shqetësuese për vendin tonë duke pasur parasysh se (Richard) Grenelli është tani më zyrtarisht i emëruar nga presidenti Trump si zyrtar i qeverisë amerikane pra si zyrtar i posaçëm për misionet të veçanta”, tha Besar Gërgi nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Engjëllushe Morina nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare shpreson që

dikush në administratën e presidentit Trump e kupton rëndësinë që ka Ballkani, rëndësinë gjeopolitike për Evropën, për marrëdhëniet euroatlantike dhe këso komente të ruhen për ndonjë ditë tjetër. “Më mirë kishte qenë që të kemi komente zyrtare prej Shteteve të Bashkuara. Mënyra më e mirë kishte qenë që të vijnë pas zgjedhjeve në Kosovë”, tha Engjëllushe Morina nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Grenelli edhe gjatë mandatit të parë të tij si i dërguar i presidentit Donald Trump për bisedimet e paqes Kosovë - Serbi e kishte kritikuar Kurtin. Grenelli njihet si autori i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike Kosovë - Serbi që u arrit në Shtëpinë e Bardhë në shtator të vitit 2020. Në pranverën e atij viti Kurti tha se Grenelli ishte përfshirë në rrëzimin e qeverisë së tij më 25 mars për shkak të mospajtimeve rreth procesit të bisedimeve Kosovë - Serbi, por kjo është hedhur poshtë nga diplomati amerikan.

Osmani në Uashington, Presidenca: Është ftuar në Lutjet e Mëngjesit, do të takohet me zyrtarë të administratës amerikane dhe kongresistë



PRISHTINË, 5 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, me ftesë të një grupi kongresistësh amerikanë, udhëtoi për në Uashington, për të marrë pjesë në Lutjet Nacionale të Mëngjesit si dhe për të mbajtur fjalim në njërin nga ngjarjet kryesore të këtij organizimi të Kongresit amerikan.

Në kuadër të kësaj ngjarjeje, e cila mbledh mijëra kongresistë, politikanë, biznesmenë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga mbarë bota, presidentja

Osmani do ta mbajë fjalimin kryesor nga përfaqësuesit ndërkombëtarë në kuadër të Drekës Ndërkombëtare. Me këtë rast, ajo do të flasë për rrugëtimin e popullit të Kosovës nga ditët më të vështira deri të sukseset e sotme, duke theksuar besimin e pashoq dhe qëndrueshmërinë e qytetarëve tanë.

Gjatë qëndrimit në Uashington, presidentja Osmani do të zhvillojë takime me kongresistë amerikanë dhe

zyrtarë të administratës së ShBA-së, me fokus në forcimin e partneritetit strategjik ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe avancimin e aspiratave euroatlantike të vendit tonë.

Lutjet Nacionale të Mëngjesit janë një traditë gjashtëdekadëshe, ku çdo vit mbledhen zyrtarët më të lartë amerikanë, anëtarë të Kongresit, politikanë dhe udhëheqës ushtarakë, si dhe mysafirë nga shumë vende të botës për lutje të përbashkëta.



KQZ-ja pranon serverë dhe pajisje përcjellëse për QNR-në, bëhet thirrje që qytetarët të votojnë më 9 shkurt

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka organizuar të mërkurën ceremoninë e pranimit të serverëve dhe pajisjeve përcjellëse për këtë qendër, donacion nga qeveria gjermane përmes OSBE-së. Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka bërë thirrje për proces të qetë zgjedhor, derisa i ka ftuar qytetarët të dalin në votime në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt. Ndërkaq Këshilli Prokurorial i Kosovës ka njoftuar për angazhimin e 100 prokurorëve për ditën e zgjedhjeve

fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor. Siç e dini, në fundjavë do të organizohet votimi në përfaqësi diplomatike në shtete të ndryshme dhe në komunat e Republikës së Kosovës. Gjatë këtyre gjashtë muajve jemi përkushtuar maksimalisht për organizimin e këtyre zgjedhjeve, me qëllim që qytetarët me të drejtë vote ta shprehin vullnetin e tyre dhe që zgjedhjet të organizohen sipas ligjit dhe sipas standardeve më të mira. Në emër të KQZ-së u bëj thirrje të gjithëve për proces të qetë zgjedhor”, ka thënë Radoniqi.

Ndërsa ambasadori i Gjermanisë, Jorn Rohde, ka thënë se digjitalizimi i procesit zgjedhor do të jetë kyç për këtë progres. “Demokracia dhe zgjedhjet e lira janë themeli i një shoqërie të zhvilluar dhe të begatë. Ato na fuqizojnë që ta formësojmë të ardhmen tonë.

Në thelb demokracia garanton lirinë individuale për secilin prej nesh. Që nga shpallja e pavarësisë Kosova ka bërë përparime të jashtëzakonshme në ndërtimin e shtetit dhe demokratizimin. Gjermania ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë përkrah jush ndërsa ecni përpara në këtë rrugë. Digjitalizimi i procesit zgjedhor do të jetë kyç për këtë progres. Prandaj, jam i kënaqur që sot, së bashku me OSBE-në, po i dorëzojmë KQZ-së pajisje dhe mjete të ndryshme”, ka thënë ai. Rohde ka thënë se ky donacion është pjesë e një projekti më të gjerë, me kontribute nga Norvegjia, Polonia dhe ShBA-ja, me një buxhet total prej 1.1 milion eurosh. “Donacioni prej pothuajse 140 000 eurosh do ta ndihmojë KQZ-në ta vazhdojë punën e saj të shkëlqyer dhe të sigurojë që proceset zgjedhore, si ato aktuale ashtu edhe ato të

ardhshme, të mbeten efikase, transparente dhe të sigurta në Kosovë dhe, natyrisht, edhe në Gjermani, ku pas tre javësh do të mbahen zgjedhje. Qëllimi ynë i përbashkët është t'i mbështesim institucionet zgjedhore të Kosovës në ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe forcimin e besimit publik në procesin zgjedhor në Kosovë. Ky donacion është pjesë e një projekti më të gjerë, me kontribute nga Norvegjia, Polonia dhe ShBA-ja, me një buxhet total prej 1.1 milion eurosh. Projekti synon t'i forcojë kapacitetet e institucioneve të menaxhimit zgjedhor të Kosovës për ta ushtruar mandatin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare, parimet e qeverisjes së mirë dhe zbatimin e rekomandimeve nga Misionet Vëzhguese të BE-së. Ky projekt është një shembull i përpjekjeve tona të përbashkëta për ta mbështetur zhvillimin demokratik të Kosovës dhe rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, ka thënë ambasadori Rohde.

Kurse ushtruesja e detyrës së shefes së Misionit të OSBE-së në Kosovë, Cornelia Taylor, ka thënë se misioni i OSBE-së në Kosovë për më shumë se një vit ka punuar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për t'i digjitalizuar hapat kryesorë të procesit zgjedhor, në përputhje me obligimet e reja të paraqitura nga Ligji për Zgjedhjet. “Së bashku kemi identifikuar

100 prokurorë do të angazhohen për ditën e zgjedhjeve në Kosovë

Ushtuesi i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka bërë me dije se 100 prokurorë do të jenë të angazhuar për zgjedhjet e 9 shkurtit. Përveç tyre, do të jenë të përfshirë edhe 30 anëtarë të stafit administrativ. Në mbledhjen e Këshillit

Prokurorial të Kosovës (KPK), Kelmendi ka theksuar se prokurorët do të jenë të pranishëm në të gjitha komunat për ta monitoruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe do ta vazhdojnë kujdestarinë edhe pas përfundimit të votimit.

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka bërë thirrje për proces të qetë zgjedhor, derisa i ka ftuar qytetarët të dalin në votime në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt 2025.

Ftesë të njëjtë ka pasur edhe për votuesit jashtë Kosovës të cilët do të votojnë në përfaqësi diplomatike, një ditë më herët, më 8 shkurt 2025. Ai i ka bërë këto deklarata nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ku është organizuar ceremonia e pranimit të serverëve dhe pajisjeve përcjellëse për këtë qendër, si donacion i Qeverisë së Gjermanisë përmes OSBE-së. Sipas tij, ky aktivitet ka për qëllim modernizimin e mëtejshëm të infrastrukturës së KQZ-së dhe është vazhdimësi e procesit të digjitalizimit të

operacioneve zgjedhore. “Dëshiroj ta shpreh mirënjohjen time dhe të KQZ-së për qeverinë gjermane për këtë donacion, i cili është realizuar përmes Misionit të OSBE-së në Kosovë. Kjo mbështetje është e çmuar dhe do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës sonë dhe avancimin e standardeve zgjedhore në Kosovë. Gjithashtu, duke pasur parasysh rolin e KQZ-së, ky donacion është një investim i madh edhe në integritetin e procesit zgjedhor dhe në besimin e qytetarëve ndaj procesit zgjedhor”, ka thënë Radoniqi. Ai ka theksuar se gjatë këtyre gjashtë muajve janë përkushtuar për organizimin e këtyre zgjedhjeve, me qëllim që qytetarët me të drejtë vote ta shprehin vullnetin e tyre dhe që zgjedhjet të organizohen sipas ligjit dhe sipas standardeve më të mira. “Aktualisht jemi në një

Kurti 3 po paralajmëron autoritarizëm pushtetar



Shkruan: Hajdin ABAZI

Me t'i fituar zgjedhjet dhe marrë pushtetin për herë të parë, në cilësinë e kryeministrit, Albin Kurti ka bërë veprime radikale - duke u konfliktuar politikisht me Trump 1, pra me aleatin kryesor të Kosovës, kurse në qëndrimet e brendshme jo duke u thirrur në politika të majta, po në emër të atdhetarizmit, luftës kundër korrupsionit e nepotizmit. Madje u bënë bashkë dy figura radikale, që të përbashkët kishin vetëm etjen zhuritëse dhe insistimin me çdo makinacion të mundshëm për t'u katrrisur në pushtet, njëri me demonstrata radikale e veprime agresive në Kuvendin e Kosovës gjoja në mbrojtje të atdheut e vet, kur erdhi në pushtet, ia fali tokën shqiptare Manastirit të Deçanit; tjetra një pehlivane politike që bënte ç'bënte - herë me njërin kundër tjetrit e së fundi edhe kundër vetë partisë; Albin Kurti e Vjosa Osmani. Ky ishte një koalicion krejt i paparimtë: Vjosa e kishte etiketuar Kurtin Chaves për të treguar dallimin politik e ideologjik, por për t'u bërë presidente nuk hezitoi të pohonte se krejt tjetër ishte Albini nga ajo që e kishte menduar; dhe përsëri, kur e kuptoi se ia kishte marrë partinë dhe se më nuk kishte gjasa të mbetej në postin e presidentes, iu sul duke e akuzuar për bixhoz me aleatët - por në atë lojë bixhozi me fatin e Kosovës kishte marre pjesë fuqishëm edhe ajo me heshtjen e saj e me mos distancimin nga ajo politikë që tash e sulmonte. Ajo iu vardis perëndimit, duke harruar se për më

shumë se tri vjet ajo kurrë nuk kishte pasur një qëndrim tjetër, që të dallonte: vetëm kur iu rrezikua posti i ra ndërmend për perëndimin. Ky tandem fatkeq për Kosovës qe në fillim u qasen të kapnin shtetin sa më shumë të mundnin. Presidentja e kapi KQZ-në, duke e shkarkuar pa të drejtë kryetaren e saj vetëm pse nuk iu nënshtrua autoritarizmit të presidentes. BE-ja reagoi ndaj këtij veprimi me shënimin në analet shtetërore për kapje të KQZ-së. Pastaj iu turr policisë dhe inteligjencës ku thuhet se i ka vendosur njerëzit e saj. Të sinkronizuar ishin Kurti, Osmani e Gërvalla lidhur me diplomacinë e shtetit, dhe me fshehtësi i larguan ambasadorë e konsuj pa asnjë analizë paraprake po vetëm me kutin “nuk është me mua, shkarkoje”. Dhe për katër vjet nuk arritën ta konsolidonin diplomacinë, nga goditja që i dhanë. Asnjë njohje. Sanksione ndaj Kosovës për herë të parë në historinë e saj, dhe atë nga BE-ja. Me SHBA: Trumpi 1 - i keq, Bideni - i keq, Trumpi 2 - i keq!? Kështu u shkatërruan diplomatikisht raportet me perëndimin dhe e futën Kosovën në “luftë të ftohtë” me BE-në dhe SHBA-në. Më keq, asnjëherë nuk ka qëndrua Kosova me aleatët e saj. Këtë nuk e ka bërë opozita, po pushteti: Kryeministri, presidentja dhe kryediplomatja! Hiç më mirë nuk është gjendja brenda.

Kurti abdikoi nga premtimet se çështjen e dialogut me minoritetin serb do ta bënte me vendorët. Ne fakt ai qe në gjendje të bashkëpunonte edhe me Radoiçiqin, kundër pagave për veteranët. Në vend të zgjidhjes politike, e shndërroi përdorimin e policisë si të vetmen alternativë. Dhe kjo, vetvetiu, i shkonte për shtati edhe Vuçiqit! Politika e tille e pa koordinuar me SHBA-në, BE-në e KFOR-in i përkeqësoi raportet me to. Listën serbe dhe çështjen e veriut i përdori

edhe kundër shqiptarëve e edhe për doza false atdhetarie te elektorati i tij. Kurti trumbeton se nuk është i korruptuar dhe se ka qeverisur me duar të pastra, por po del e kundërta: se ka qenë në strukturën grupore në WhatsApp që ka kontrolluar tenderët dhe punësimet, kjo e lidhur me aferën 37 milionëshe në KEK dhe aktakuzën ndaj Nagip Krasniqit. Këto janë fakte për inkriminim në korrupsion, ashtu sikurse ishte dhe afera me rezervat e shtetit. Korrupsioni brirë nuk ka, po kështu bëhet. Por duket se ato që kanë ndodhur, si kapja e shumë institucioneve përfshirë RTK-në dhe komisionin për media, ishin minore në krahasim me ato që po paralajmëron Kurti. Mospërgjigjja ndaj prokurorisë për intervistim është një tregues që Kurti nuk e njeh drejtësinë dhe në këtë kontekst deklarimi që prokurori të shkojë te kryeministri - është shantazh publik për të vendosur autoritarizmin e tij mbi drejtësinë. Kurti tashmë ka deklaruar se ka mësuar se si ta “reformojë” drejtësinë: duke e nënshtruar atë. Kur të gjejë mënyrën për të vendosur njerëzit që vullnetin e tij e bëjnë drejtësi - atëherë ai do ta pranojë sistemin e drejtësisë së Republikës sonë. Dhe ne që e kemi përjetuar “drejtësinë komuniste” e dimë se si është ajo: përmes partisë dhe njerëzve të zgjedhur nga Kurti, gjykatësit do të ndajnë drejtësinë sipas kriterëve të Kuetit. Ata që janë me të - edhe kur vjedhin përmes tenderëve, edhe kur kapen me drogë, edhe kur inkriminohen, ose nuk arrestohen fare ose shpallen të pafajshëm. Kurse oponentët e kritikët dënohen me inskenime (mbase mund ta fus në ndonjë ligj një nen “për propagandë armiqësore” sikurse e kishin regjimet komuniste). Ngjyrimet komuniste shprehu Kurti edhe në tubimin

zgjedhor në Kaçanik, ku deklaroi se vetëm ata që nuk i duan fëmijët e tyre e familjen mund të mos e votojnë LVV-në. Kjo është maksima se më e dashur është ideologjia se sa gjithçka e çdo gjë tjetër. Ky pretendim i Kurtit është flagrancë me frymën demokratike, që garanton se liria e zgjedhjes dhe e votimit sipas vullnetit të lirë nuk është armiqësi - po e drejtë e secilit. Ka edhe më. Ai deklaroi me pompozitet se duke më thënë “Albin baba” (dhe e tha këtë me ekzaltim) ju e keni fjalën që të m'i besoni fëmijët tuaj t'i edukojë e t'i rrisë. Kjo është e pa cipë dhe e pamoralshme. Para se ta marrë përsipër t'i edukojë fëmijët e të tjerëve anekënd vendit do të ishte e ndershme që ta sillte fëmijën e vet që ta edukonte në Kosovë. Jo, fëmijën e vet dëshiron ta edukojë në një vend me kulturë të lartë, kurse fëmijët e të tjerëve t'i shndërrojë sipas mendësisë komuniste në “njerëz të rinj” trushpërlarë! Krahas këtyre, Kurti e shpërfaqti me një ton diktatorial dëshirën e tij reale. Tha se jo vetëm do t'i mundim, por edhe do t'i shkatërrojmë dhe do ta zhdukim opozitën. Kjo është mendësi tipike komuniste, tiranike dhe e diktatorëve, që nuk lejojnë mendim opozitar, oponencë dhe alternativë. Kur kësaj t'i shtohet edhe lufta kundër mediave e gazetarëve kritikë, atëherë bëhet e plotë tabloja. Duhet të mbeten në pushtet e në institucione vetëm bashkëmendimtarët, qenë e nuk qenë profesionistë - mjafton të jenë të dëgjueshëm si Nagip Krasniqi! Dhe ajo që ishte e turpshme që do të ishte e pritshme vetëm prej qeveritarëve pushtues, ishte shkuarja në Skenderaj për tubim elektorale. Kryeministri i veshur me pancir, thua se ka shkuar në veri ku mundet ndonjë i rekrutuar nga Radojçiqi të bënte atentat.

Një veturë ia paska pre rrugën suitës policore në përcjellje të kryeministrit, dhe kjo u cilësua hiç më pak se sulm! E pra Kurti e militantët e tij dikur njëmend i sulmonin kryeministrat, ju shkonin te shtëpia e i kërcënonin dhe madje ju hidhnin thumba gomëshpues veturave qeveritare për t'i përmbysur - që njëmend ishte një lloj tentimatentati. Mënyra se si shkuan në Skenderaj ishte provokativ me gjithçka, por drenicasit nuk ranë në kurth. Ata reagan në mënyrë shume demokratike, me çka de facto ia prishën skenarin djallëzor. Në jetën time nuk kam parë një politikan më gënjeshtar publik se sa Kurti. Ai vazhdimisht ka mashtruar se mirë i ka Kosova punët me SHBA-në. E doli se nuk i kishte ashtu, as me Bidenin i cili kurrë nuk e takoi e nuk e priti në Shtëpinë e Bardhë. Këtë marifet e tentoi edhe tash me Trumpin 2, madje edhe ju servilua paksa (një shakaxhi do të tallej duke i vënë në gojën e Kurtit fjalët alegorike: “E lëshova bojlerin”). Grenelli, emisari special i presidentit Trump, e demantoi: Kosova nuk i ka punët aspak mirë me SHBA-në dhe nuk do t'i ketë mirë përderisa të jetë Kurti kryeministër. Kosova nën sanksione, asnjë komunikim miqësor me ata që i kemi partnerë e sidomos me SHBA-në, me shtetin e kapur dhe me një paralajmërim për kapje absolute, Kurti po tregon se çka e pret Kosovën në mandatin e tij të tretë nëse e fiton: një autoritarizëm, ku përndjekja, reprezaliet dhe eliminimi politik i atyre që mendojnë ndryshe do të jenë veprime sistematike, dhe izolimi do të vazhdojë. Gjithnjë kam qenë kundër regjimeve të tilla autoriale dhe kurrë nuk do të pajtohem me të, nuk do të pajtohem ekskluzivisht për shkak se pasojat politike do të jenë tepër të rënda për Kosovën dhe lirinë e qytetarëve të saj.

nevojat, kemi zhvilluar specifikime të hollësishme dhe kemi siguruar teknologji të përshtatshme, të cilën po e dorëzojmë sot, për ta përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe integritetin e menaxhimit të zgjedhjeve në Kosovë. Tre serverët që po ju dorëzojmë sot janë blerë me mbështetjen bujare të Gjermanisë dhe përbëjnë pjesën e fundit që plotëson mozaikun e këtij projekti në të cilin kemi punuar gjatë vitit të kaluar. Ata do t'i mundësojnë Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve të krijojë një infrastrukturë teknologjike të besueshme, e cila siguron funksionimin e pandërprerë të proceseve të digjitalizuara zgjedhore dhe numërimit të votave”, ka thënë ajo. Taylor ka thënë se misioni i OSBE-së mbetet partner i palëkundur në mbështetjen e institucioneve demokratike, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e integritetit zgjedhor. “Në fund të fundit, një dhomë serveri që funksionon mirë është shtylla

kurrizore e administrimit modern të zgjedhjeve, duke garantuar që operacionet t'i përmbushin standardet më të larta të saktësisë, sigurisë dhe transparencës. Në këtë ditë të gjitha sytë do të jenë te ju për të siguruar një proces zgjedhor të qetë dhe të rregullt, të cilit të gjithë mund t'i besojnë. Ne në misionin e OSBE-së mbetemi partner i palëkundur në mbështetjen e institucioneve demokratike, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e integritetit

zgjedhor”, ka thënë ajo. Në hyrje të kësaj ceremonie, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar për digjitalizimin e disa operacioneve zgjedhore gjatë këtij procesi zgjedhor. “Prej vitesh KQZ është munduar t'i lehtësojë shërbimet për votuesit, subjektet politike dhe vëzhguesit, përmes mundësive që ofron teknologjia, por në këtë proces zgjedhor ka pasur digjitalizim të një numri të madh të operacioneve zgjedhore dhe përmirësim të

shërbimeve që ekzistojnë në herët. Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës; kërkimi i Qendrës së Votimit dhe aplikimi për ndryshimin e saj; aplikimi për regjistrimin e votuesve me nevojave të veçanta, aplikimi për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve; aplikimi për akreditimin e vëzhguesve; e të tjera, janë disa nga platformat elektronike që kanë përmirësuar shumë shërbimet e KQZ-së për përmbushjen e detyrimeve ligjore”, ka thënë Elezi.

Kurti premton ndërtimin e dy spitaleve të reja, një në Mitrovicë e një në Ferizaj

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, njëherësh kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vazhduar takimet me qytetarë, ku po kërkon mbështetje për zgjedhjet e 9 shkurtit. Kurti ka bërë disa

premtime. “Punët e mira po vazhdojnë. Nga klinikë pas klinike do të vazhdojmë spital pas spitali. Në mandatin e ri, krahas ndërtimit të klinikave specialistike në gjashtë komuna, do të ndërtojmë

edhe dy spitale të reja, një në Mitrovicë dhe një në Ferizaj, si dhe do t'i modernizojmë spitalet e tjera rajonale”, ka theksuar Kurti. Zgjedhjet parlamentare do të mbahen më 9 shkurt.



“Kosova direkt në NATO”, Haradinaj falënderon mbështetësit e fushatës zgjedhore



PRISHTINË, 5 SHKURT - Në prag të zgjedhjeve parlamentare, kandidati për kryeministër, Ramush Haradinaj, po përmbyll fushatën zgjedhore me një sërë tubimesh në qytete të ndryshme të Kosovës, duke ripërsëritur zotimin për një Kosovë të fortë, anëtare të NATO-s dhe aleate e ngushtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “E nisëm bashkë duke nderuar sakrificën për liri në Prekazin heroik dhe po e përmbyllim me tubime madhështore në mbarë vendin”,

u shpreh Haradinaj, duke vlerësuar entuziazmin e qytetarëve. Agjenda e kandidatit për kryeministër përfshin takime me banorët e Kabashit në Korishë të Prizrenit, rininë e Suharekës dhe komunitetin e Lubizhdës. Në ditët në vijim Haradinaj do t'i vizitojë Rahovecin, Krushën e Madhe dhe Gjakovën, për ta përmbyllur fushatën me një tubim madhështor në Pejë. “Të dielën vendosim për Kosovën ku

fitojnë të gjithë. Vendosim për fatin tonë. Vendosim për fëmijët tanë”, theksoi lideri i koalicionit për Kosovën Fituese, duke ftuar qytetarët të votojnë numrin 137 më 9 shkurt. Fushata e Haradinajt është karakterizuar nga një fokus i veçantë në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, veçanërisht me aleatët perëndimorë, duke e vendosur anëtarësimin në NATO si një nga prioritetet kryesore të programit qeverisës.

Abdixhiku merr mbështetje nga EPP-ja

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kandidati për kryeministër i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka njoftuar se ka marrë mbështetje nga EPP, familja më e madhe politike e partiake në BE dhe Evropë. Ai ka thënë se kjo mbështetje është nderim për të, LDK-në dhe Kosovën. “Presidentin e EPP-së, Manfred Weber, e falënderoj për

mesazhin dhe mbështetjen e dhënë në këto zgjedhje historike për vendin tonë. E djathta po merr forcë rekorde në Evropë dhe botë; prandaj si vend, si Republikë, si shoqëri, duhet t'i kapim këto mundësi të jashtëzakonshme historike për vendin tonë. Kthimi nga rrugëtimi euroatlantik është akt

patriotik sot. LDK, unë, dhe populli i Kosovës, do ta bëjmë këtë! EPP, mbetet forca kryesore në kontinent. Ajo po forcohet tutje me zgjedhjet e ardhshme në Gjermani dhe jo vetëm. Prandaj, ditë e momente të bukura na presin përpara”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



Hoxhaj paraqet planin e PDK-së: Dyfishim të buxhetit për mbrojtje dhe forcim të FSK-së



PRISHTINË, 5 SHKURT - Kandidati për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka paraqitur planin e PDK-së për mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës. Hoxhaj në rrjetin social në “Facebook” ka publikuar një video adresuar qytetarëve, duke theksuar përkushtimin

për përmbylljen e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), dyfishimin e buxhetit për mbrojtje dhe nënshkrimin e një Marrëveshjeje për Siguri dhe Mbrojtje me ShBA-në. Ai ka zbuluar një plan veprimi për anëtarësimin e Kosovës në NATO, duke e cilësuar hap strategjik për garantimin e

paqes dhe sigurisë afatgjatë të vendit. “Vetëm kështu mund ta bëjmë një Kosovë të sigurt në një Evropë të pasigurt”, ka thënë Hoxhaj. Ndërkaq plani i PDK-së në këtë drejtim synon t'i forcojë aleancat ndërkombëtare dhe të sigurojë mbështetje për avancimin e Kosovës në strukturat euroatlantike.

Koalicioni për Familjen kërkon votën në Hajvali

PRISHTINË, 5 SHKURT - Koalicioni për Familjen mbajti një tubim në Hajvali, ku morën pjesë qytetarë të shumtë dhe drejtues të rëndësishëm të koalicionit. Gjatë këtij tubimi, përveç liderëve të koalicionit, Eman Rrahmani, Selim Pacolli, Ferid Agani dhe Fatmir Smajli, një mbështetje të fuqishme dhe të veçantë për koalicionin dha edhe kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli. I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Adem Shehu, i cili theksoi se kishte ardhur enkas nga Shqipëria për ta mbështetur Koalicionin për Familjen pasi, siç tha ai, “familja është e shenjtë”. Në fjalën e tij, Behgjet Pacolli theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të fortë mes qytetarëve dhe koalicionit, duke garantuar një të ardhme më të mirë për familjet. Ai theksoi mbështetje të plotë për kandidatët e koalicionit dhe bëri thirrje qytetarët që të angazhohen fuqishëm për t'i mbështetur kandidaturat e

koalicionit për deputetë në zgjedhjet e ardhshme. Drejtuesit e koalicionit falënderuan qytetarët e Hajvalisë për praninë dhe angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm, duke shprehur mirënjohje për mbështetjen që dhanë gjatë këtij tubimi, i cili ishte mbushur me entuziazëm dhe optimizëm. Ata theksuan se ky ishte vetëm fillimi i një fushate të fuqishme për mbrojtjen e interesave të familjeve të Kosovës dhe për një të ardhme më të mirë për vendin.



Shoqata e Distributorëve kërkon shtyrjen e afatit për çmimet e barnave dhe mbrojtjen e stokeve aktuale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 5 shkurt - Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës përmes Odës Ekonomike të Kosovës i është drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë, ku ka kërkuar shtyrjen e afatit të implementimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale.

Kështu ka bërë me dije kjo shoqatë përmes një njoftimi. “Në lidhje me vendimin e datës 31.12.2024 përmes të cilit është miratuar lista zyrtare e

çmimeve të produkteve medicinale dhe hyrja e saj në fuqi është caktuar për datën 01.02.2025, dëshirojmë të theksojmë disa sfida praktike dhe implikime ekonomike që rrjedhin nga afati i shkurtër i implementimit”, thuhet në kërkesën e ShDPMK-së drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.

Kjo shoqatë ka kërkuar që të mos preket stoku aktual i barnave - produktet medicinale që janë importuar më herët dhe ndodhen në depot e qarkulluesve farmaceutikë me shumicë dhe në barnatore të mos i nënshtrohen vendosjes



retroaktive të çmimeve të reja, pasi një masë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimin se ligjet zbatohen retroaktivisht

vetëm kur janë në dobi të palës. ShDPMK ka kërkuar të zgjatet perioda e hyrjes në fuqi të çmimeve të reja minimumi 6

muaj, në mënyrë që të mundësohet menaxhimi i stokeve ekzistuese dhe shitja e tyre me një marzh të pranueshme fitimi deri në pastrimin e tyre. “Kërkojmë që stoqet ekzistuese të barnave të mos preken nga çmimet e reja. Produktet e importuara më herët janë blerë me çmime të tjera dhe nuk mund të shiten me humbje. Ligji nuk mund të zbatohet retroaktivisht për dëm të palës. Afati i hyrjes në fuqi të zgjatet për të paktën 6 muaj. Kjo do të lejonte menaxhimin dhe shitjen e stokeve ekzistuese me një marzh të pranueshme fitimi”, thuhet në kërkesë.

Policia e Kosovës vë në pranga të dyshuarin që komprometoi mbi 300 mijë kartela bankare në një shtet të BE-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 SHKURT - Një person është arrestuar pasi dyshohet se ka hyrë në mënyrë të paautorizuar kompjuterike në një bankë të një shteti të BE-së, veprim i cili ka rezultuar në komprometimin e të dhënave të mbi 300 mijë kartelave bankare, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm. Sipas një njoftimi të Policisë së Kosovës, bëhet me dije se ky operacion është zhvilluar në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit të Republikës së



Kosovës dhe autoritetet e një shteti të BE-së. “Policia e Kosovës, në bashkëpunim me prokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe

autoritetet e një shteti të BE-së, ka zhvilluar një operacion të suksesshëm hetimor në Prishtinë dhe Ferizaj. Pas një hetimi disamujor është

arrestuar një person i dyshuar për hyrje të paautorizuar kompjuterike në një bankë të një shteti të BE-së. Ky veprim ka rezultuar në komprometimin e të dhënave të mbi 300 mijë kartelave bankare, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm. I dyshuari dyshohet se i ka postuar për t'i shitur këto të dhëna në një platformë online për përfitime të kundërligjshme. Gjatë realizimit të operacionit të kontrollit janë sekuestruar katër kompjuterë, tre telefona, një USB dhe dokumente të rëndësishme”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

PK-ja ka njoftuar se bashkëpunimi i ngushtë ndërkombëtar dhe profesionalizmi i lartë i Policisë së Kosovës kanë qenë kyç në këtë operacion. “Me vendim të prokurorit i arrestuari është ndaluar për 48 orë për procedura të mëtejme. Hetime të tjera janë në proces në bashkërendim me autoritetet për ta zbardhur plotësisht rastin. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e krimeve kibernetike edhe në nivel të avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimin e sigurisë publike”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Për herë të parë në QKUK fillon Skriningu Neonatal Metabolik


EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës për herë të parë në Kosovë po fillon Skriningun Neonatal Metabolik, një program jetik që mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve të rënda metabolike dhe gjenetike tek të porsalindurit.

Ky është një hap i madh përpara në kujdesin shëndetësor për foshnjat tona dhe një arritje e rëndësishme për sistemin shëndetësor në vend.

Ky kryhet brenda 24 deri në 48 orë pas lindjes dhe ndihmon në diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve që mund të mos shfaqin simptoma menjëherë, por që mund të kenë pasoja të rënda



për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës. “Përmes këtij shërbimi mundësojmë zbulim të hershëm të sëmundjeve si: hipotiroidizmi kongjenital, fenilketonuria, fibroza cistike, galaktozemia dhe atrofia muskulare spinale (SMA). Po ashtu, arrihet parandalimi i komplikimeve serioze, si paaftësia mendore dhe fizike, përmirësimi i cilësisë së jetës për fëmijët dhe familjet e

tyre, si dhe siguri për prindërit, duke mundësuar trajtim të hershëm dhe efektiv. Për ta siguruar zbatimin me sukses të këtij programi, kemi filluar trajnimin e stafit shëndetësor në Klinikën e Neonatologjisë në QKUK dhe në spitalet rajonale, për kryerjen e testeve dhe menaxhimin e rasteve të identifikuar”, ka njoftuar ShSKUK-ja.

AAK-ja nënshkruan deklaratën e zotimit për përfshirjen e të drejtave të personave me nevoja të veçanta në praktikat qeverisëse

PRISHTINË, 5 SHKURT - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka nënshkruar një deklaratë të zotimit që synon përfshirjen e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e

personave me nevoja të veçanta në praktikat qeverisëse. Kjo deklaratë është nënshkruar me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta dhe sigurimin e një jetese të pavarur dhe

dinjitetshme për të gjithë qytetarët, pa asnjë diskriminim, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara. Ky angazhim tregon vullnetin e AAK-së për të

siguruar përfshirje të plotë dhe mundësi të barabarta për çdo individ në shoqëri, duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen e dinjitetshme në jetën sociale, ekonomike dhe politike.



Modifikohet formulari “WR” për tatimet e mbajtura në burim

PRISHTINË, 5 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se është modifikuar formulari “WR” përmes të cilit deklarohen tatimet e mbajtura në burim, si: tatimi në interes, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari, lojëra të fatit dhe tatimi për personin jorezident. Ndryshimet në formularin e lartcekur “WR” aplikohen nga periudha janar 2025. Këto ndryshime lehtësojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, të

cilët realizojnë transaksione ndërkombëtare, ndërsa për tatimpaguesit që realizojnë transaksione brenda vendit nuk kanë ndikim. Në listën (excel file) e cila ngarkohet me rastin e dorëzimit të formularit “WR”, është shtuar një kolonë e re “Shteti” në të cilën tatimpaguesit duhet të vendosin emrin e shtetit me të cilin kanë realizuar transaksione ndërkombëtare. Nga periudha janar 2025 e tutje, përderisa tatimpaguesit

deklarojnë formularin “WR” përmes listës së re, në të cilën plotësohet edhe informata për shtetin me të cilin personi ka transaksione ndërkombëtare, nuk kërkohet të dorëzohen në ATK edhe formularët për zbatimin e Marrëveshjeve për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, siç është kërkuar deri më tani. Pra, nga viti 2025 e tutje nuk kërkohet që tatimpaguesit të dorëzojnë në ATK formularët, si formulari - Të ardhurat nga



Interesi; Formulari - Të ardhurat nga Dividenta; Formulari - Të ardhurat nga të Drejtat Pronësore; Formulari - Fitimet Kapitale; Formulari - Të ardhurat e tjera; Formulari

- Të ardhurat nga Shërbimet e Pavarura; Formulari - Të ardhurat nga Shërbimet e Varura; dhe Formulari - Të ardhurat nga Fitimet Biznesore.

Ismaili takon ekspertët e Misionit të Bankës Botërore, flasin për projektin më të ri për zhvillimin e sektorit financiar

PRISHTINË, 5 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorët Dardan Fusha dhe Milot Cakaj dhe bashkëpunëtorë, ka takuar ekspertët e Misionit të Bankës Botërore (BB) në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Sektorit Financiar (FinDev) me praninë e Massimiliano Paolucci, menaxher i vendit për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, në Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore të Bankës Botërore. Temat kryesore për diskutim ishin përgatitjet e nevojshme për zbatimin e Projektit më të ri për Zhvillimin e Sektorit

financiar, përkatësisht komponentëve të digjitalizimit të shërbimeve financiare (sistemi i pagesave të shpejta) si dhe rritja e stabilitetit të sektorit financiar përmes avancimit të kornizës rregullative dhe kapitalizimit të Fondit të Sigurimit të Depozitave. Përfaqësuesit e BQK-së në këtë takim njoftuan ekspertët e BB-së mbi aktivitetet e fundit të BQK-së në funksion të realizimit të objektivave dhe të Planit Strategjik, procesin e para-aplikimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA) dhe procesin e zhvillimit të sistemit të pagesave të shpejta të Eurosistemit, i njohur si TIPS.



Gjithashtu, ata u njoftuan edhe për aktivitetet e ndërmarra nga BQK për avancimin e infrastrukturës teknike të BQK-së. Guvernatori Ismaili, duke shprehur falënderimin për

mbështetjen e Bankës Botërore, ka informuar edhe për zhvillimet në sektorin financiar, veçanërisht miratimin e Udhërrëfyesit Strategjik për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen e rreziqeve të

lidhura me klimën dhe mjedisin në sektorin financiar, e cila ishte me mbështetjen e Qendrës Këshilluese për Sektorin Financiar (FinSAC) të Bankës Botërore. Paolucci rikonfirmoi mbështetjen e Bankës Botërore për projektet në proces dhe shprehën gatishmërinë për zhvillimin e tyre sipas planifikimeve të parapara. Kjo vizitë nënvizon bashkëpunimin e shkëlqyeshëm midis dy institucioneve si dhe mbështetjen e vazhdueshme të BB-së për ta avancuar stabilitetin financiar si dhe modernizimin e shërbimeve të sektorit financiar të vendit.

Rritet indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore

PRISHTINË, 5 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e katërt (TM4) 2024. Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e

prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Në TM4 2024 indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 1,5 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 5 %. Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 2,7 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.



Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet

blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjalhtë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Posta e Kosovës lëshon pullë postare për transmetimin e parë nga Radio Prishtina

PRISHTINË, 5 SHKURT - Filatelia e Postës së Kosovës ka lëshuar një emision të veçantë pullash postare për nder të 80-vjetorit të Radio Prishtinës, mediumit të parë radiofonik në Kosovë. Kjo pullë përkujton transmetimin e parë në Prizren më 1945, i cili, me kalimin e kohës, evoluoi në një institucion kyç të informacionit dhe kulturës në vend. Pas disa vjetësh Radio Prishtina u zhvendos

në kryeqytet, duke u bërë qendra kryesore e transmetimeve radiofonike. Me themelimin e Radio Televizionit të Prishtinës më 1974 ajo u integrua në një dritare të re informative dhe kulturore, duke luajtur rol të rëndësishëm në promovimin e gjuhës, kulturës dhe traditave vendore. Për dekada ky medium ka qenë simbol i profesionalizmit dhe rezistencës kulturore, duke

shërbyer si një urë lidhëse me botën. Ky jubile është një moment reflektimi mbi kontributin e gazetarëve, redaktorëve dhe teknikëve që ndërtuan një trashëgimi të pasur mediatike. Posta e Kosovës fton koleksionistët, bizneset dhe qytetarët të blejnë këtë pullë speciale, e cila përjetëson historinë dhe rëndësinë e Radio Prishtinës në zhvillimin e komunikimit dhe kulturës në Kosovë.



Në Aushvic isha e detyruar të kërceja për Mengelen

“Mengele më pa drejt e në sy dhe më tha: ‘Kërce’. Dhe unë kërceva. Nuk do ta harroj kurrë atë vështrim. Por falë atij kërcimi, shpëtova jetën time.”

Edith Eger ishte 16 vjeçe kur “engjëlli i vdekjes” hodhi sytë mbi të: “Kërce!”, i tha. Në momentin e çlirimit, peshonte 32 kilogramë. Sot tregon se si shpëtoi dhe pse, pas ferrit, zgjodhi të ndihmonte të tjerët.

“Mengele më pa drejt e në sy dhe më tha: ‘Kërce’. Dhe unë kërceva. Nuk do ta harroj kurrë atë vështrim. Por falë atij kërcimi, shpëtova jetën time.”

Edith Eva Eger, hebrije sllovako-hungareze, autore e “Balerina e Aushvicit”, është një nga të mbijetuarat e

fundit të Holokaustit. E deportuar nga nazistët dhe e liruar në vitin 1945, pas luftës u bë psikologe dhe ia kushtoi jetën shërimit të pacientëve me stres post-traumatik. Nëse ia doli të mbijetonte, ishte edhe sepse në Aushvic kërceu për Engjëllin e Vdekjes, Josef Mengelen.

“Kur më pyesin nëse e kam lënë pas të kaluarën, u përgjigjem jo, nuk do ta harroj kurrë, por e kam përballuar. Nuk mund ta ndryshosh atë që ka ndodhur. Por mund të zgjedhësh të jesh e lirë nga ai kujtim dhe të



ndërtosh një jetë tjetër. Të lumtur, të plotë.”

“Nëna do të kthehet shpejt”

E lindur në Sllovaki, vajza e një rrobaqepësi dhe një nëpunëseje shtetërore, në vitin 1944 Edith ishte 16 vjeçe, mendonte vetëm për kërcimin dhe dashurinë e saj të parë, Erikun. “Ishte i pashëm, kishte një aromë të këndshme.”

Jeta në geton e Košicës i jepte ende copëza normaliteti: në mbrëmje, ajo dhe Eriku sfidonin shtetrrethimin për të shkuar në kinema, me yjet e verdhë të fshehura nën pallto. Deri atë natë të majit. “Nazistët erdhën duke bërë titur. Nënës sime i lejuan vetëm një valixhe për të gjithë familjen.” I priste një vagon mallrash dhe një udhëtim që zgjati me ditë, pa patur një arsye. Dhe pa Erikun, i cili u dërgua diku tjetër.

Kur treni u ndal me një kërcitje në platformën e Aushvicit, një oficer i ndau prindërit e Editës në një radhë, ndërsa atë dhe motrën e saj, Magdën, në një tjetër. “Një burrë më tha: ‘Mos u shqetëso, nëna po shkon vetëm për të bërë një dush’. Nuk e pashë më kurrë.”

Burri që i foli ishte Josef Mengele.

Të grumbulluara në barakat e kampit, të rraskapitura nga uria, Edith dhe Magda i thoshin njëra-tjetrës se ishin të bukura, “për të mbajtur veten, dhe sepse nuk kishte pasqyrë”. Gjithçka, vetëm për të mbijetuar.

Shefi i kampit i paralajmëroi: Mengele ishte një adhurues i arteve, shpesh kërkonte të burgosur të talentuar që ta

argëtonin. Violinistë, poetë. Balerinë.

Një mbrëmje, nazisti i hodhi sytë mbi Edithin. “Vogëlushja ime balerinë, kërce për mua.” Dhe Edith kërceu, me këmbët e rënda, mbi notat e Danubit Blu, ndërsa Mengele diskutonte me vartësit se kë do të dërgonin në “dushe” të nesërmen. “I thosha vetes: nëse gaboj ndonjë hap, do të vdes. Ose do të vdesë motra ime. Ose do të vdesim të gjitha. Bëja pirueta duke menduar fjalët e mësuesit tim të kërcimit: ‘Mbaje mend, ekstazia është brenda teje.’”

E dinte se Mengele e shihte si një copë mishi, por nuk ndiente zemërim. Ndiente mëshirë. Për mjerimin e tij. Shpërblimi i saj ishte një copë bukë. Edith dhe shoqet e saj të barakës do ta ruanin për ditë të tëra.

E transferuar në kampin Gunskirchen, në maj të vitit 1945, një ushtar amerikan e pa Edithin mbi një grumbull kufomash. Ajo peshonte 32 kilogramë, por ende merrte frymë. “E kam kërkuar kudo atë ushtar. Doja t’i thosha faleminderit.” Edhe motra e saj Magda u shpëtua. Por Eriku nuk ia doli.

E turpëruar që ishte gjallë

Si mund të rezistosh ndaj gjithë kësaj? Si mund të fillosh të marrësh frymë sërish?

Në atë Amerikë që e shpëtoi, ku sot jeton pranë tre fëmijëve, pesë nipërve dhe shtatë mbesave e nipërve të vegjël, doktoresha Eger buzëqesh butësisht: “Zgjodha gëzimin”. Pas çlirimit, si shumë të mbijetuar të tjerë, u ndje fajtoare. U ndje e turpëruar që ishte gjallë.

E shtruar në spital, pa flokë, jetime dhe e goditur nga një

traumë e pamundur për t’u përballuar, nuk arrinte të imagjinonte një të ardhme. “Për muaj të tërë, zgjohesha në mëngjes duke pyetur veten, çfarë kuptimi kishte të hapja sytë. Pastaj fillova të mendoja se nëse do të jetoja, duhet të jetoja për diçka. I detyrohesha vetes sime. I detyrohesha prindërve të mi dhe gjashtë milionë të vdekurve.”

Bélan, burrin e saj, e takoi në spital. Me të pranë, vendosi të bëhej nënë. “Kur i thashë mjekut se isha shtatzënë, ai më tha se isha shumë e dobët për të mbajtur një shtatzëni. Më këshilloi të abortoja. Iu përgjigja: ‘Unë dua të sjell jetë në këtë botë’. Kur lindi, vajza ime peshonte 4 kilogramë.”

Hakmarrjen nuk e kërkoi kurrë. Por padrejtësisë, Edith i është rebeluar gjithmonë. Në Amerikën e viteve ’50, ku ende kishte tualete të ndara për racat, të bardhët nga njëra anë, zezakët nga tjetra, Edith hynte gjithmonë në ato të destinuara për gratë me ngjyrë. Për parim, sepse nuk ka duruar kurrë asnjë formë diskriminimi.

Më pas, erdhi dëshira për të ndihmuar ata që vuanin, si psikologe. “U thosha gjithmonë pacientëve të mi: ‘Të gjithë kemi një zgjedhje. Mund të zgjidhni të jeni viktimë ose të jetoni plotësisht.’”

Vite pas çlirimit të saj, vendosi të kthehej në Aushvic. Për t’ia parë tmerrin në sy. “Për të zgjedhur të vazhdoja të jetoja.”

Primo Levi shkroi: “Ka Aushvic, pra nuk mund të ketë Zot”.

Po Edith, a vazhdon ende të besojë?

Doktoresha Eger peshon fjalët dhe pastaj buzëqesh: “Zoti është brenda meje. Dhe edhe brenda jush. Mjafton ta kërkosht.” / Oggi – Bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gjimshiti në formacionin e javës në Serie A

BERGAMO, 4 SHKURT - Mbrojtësi Berat Gjimeshi është futbollisti i vetëm shqiptar që ka zënë vend në formacionin më të mirë të javës së 23-të në Serie A të Italisë. Futbollisti i

Shqipërisë është vlerësuar lart për paraqitjen e tij në barazimin 1:1 të Atalantas kundër Torinos, ndeshje kjo e luajtur javën e shkuar. Gjimeshi ka shënuar gol në këtë ndeshje dhe ka fituar 8

prej 9 dueleve me kundërshtarët, duke u vlerësuar me notën 8.2, e cila i ka siguruar një vend në formacionin më të mirë të javës. 31-vjeçari është kapiten i Atalantas dhe njëri

ndër mbrojtësit më të vlerësuar në Serie A. Në 32 ndeshje të luajtura në të gjitha garat deri më tani, ai ka shënuar edhe dy gola për Atalantan, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2026.



Vojvoda pas transferimit te Como: Jam i lumtur dhe krenar

COMO, 4 SHKURT - Mbrojtësi i Kosovës, Mërgim Vojvoda, në fund të afatit kalimtar të janarit ka vendosur të ndryshojë skuadër. Ai mbetet në Seria, por nga Torino tash ka kaluar tek Como. Vojvoda ka nënshkruar me këtë klub deri në vitin 2028-të. 30-vjeçari pasi i dha fund eksperiencës së suksesshme me Torinon, foli për herë të parë si futbollist i ri i Comos, ku iu bashkua trajnerit Cesc Fabregas, i cili e kërkoi atë me ngulm. Mbrojtësi i djathtë, por njëkohësisht edhe i djathtë ndihet i lumtur për këtë transferim, ndërsa premtan se do ta japë më të mirën nga vetja. “Jam i

lumtur dhe krenar që jam këtu dhe i gatshëm për të ndihmuar ekipin. Serie A nuk është një ligë e lehtë, por mendoj se skuadra ka cilësi. Kam biseduar me trajnerin dhe jam këtu për të punuar për projektin”, ka thënë Vojvoda pasi nënshkroi me Comon. Vojvoda i ka zhvilluar mbi 100 ndeshje në Serie A me Torinon dhe përvoja është në anën e tij. Me Comon, futbollisti me prejardhje nga Drenica synon ta ruajë statusin e ekipit elitare në futbollin italian. Ai u lind në Liege të Belgjikës. Mërgim Vojvoda ka luajtur në disa klube të atjeshme, përfshirë këtu Standard Liège dhe Royal

Excel Mouscron. Ai po ashtu është pjesë e rregullt dhe e rëndësishme e Kombëtares së Kosovës, me të cilën i ka mbi 60 paraqitje që prej debutimit të tij në vitin 2016.

Fabregas: Vojvoda ka eksperiencën e duhur, do ndihmojë Comon


Trajneri i Comos, Fabregas, në një intervistë të dhënë së fundmi, vlerësoi në maksimum mbrojtësin shqiptar, Mërgim Vojvoda. “Mërgimi sjell përvojë, këmbëngulje dhe qëndrueshmëri në mbrojtje në skuadrën tonë. Aftësia e tij për të operuar në role të



shumta mbrojtëse dhe përvoja e tij në Serie A do të jenë të paçmueshme ndërsa ne vazhdojmë ta forcojmë

vijën tonë defensive”, ka deklaruar Fabregas. Vojvoda ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2028.

Shqipëria dhe Serbia e fitojnë të drejtën e organizimit të Evropianit U-21



TIRANË, 4 SHKURT - Shqipëria dhe Serbia do ta organizojnë Kampionatin Evropian të Futbollit për moshat U-21. Kjo u vendos në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. Pra, gjithçka u konfirmua të martën nga shtëpia e futbollit evropian, me dy vendet që do ta organizojnë këtë eveniment në vitin 2027.

Në Shqipëri ndeshjet do të luhen në Tiranë, Shkodër, Durrës e Elbasan. Evropiani U-21 do të hapet në stadiumin “Karadjordje” të Novi Sadit, ndërsa do të luhet edhe në Leskovc, Zaječar dhe Loznicë. E finalja do të luhet në stadiumin “Air Albania” në Tiranë. Shqipëria do t’i luajë ndeshjet në Shqipëri e Serbia

në Serbi. Vetëm nëse shkojnë eventualisht në finale, serbët do të luanin në Shqipëri. Shqipëria, si organizatore, do ta fitojë të drejtën e kualifikimit direkt në këtë eveniment, i cili është kritikuar me të madhe nga shqiptarët anembanë botës shkaku i së kaluarës mes dy popujve.

Vlora Braha, delegatja e parë teknike nga Kosova në kualifikimet për FIBA Kampionatin Evropian për Femra

PRISHTINË, 4 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës ka kënaqësinë të njoftojë se, Vlora Braha do të jetë për herë të parë në rolin e Delegates Teknike në një ndeshje kualifikuese për FIBA Kampionatin Evropian 2025 për Femra. Ajo do të jetë Delegate Teknike në ndeshjen mes Turqisë dhe Islandës, që zhvillohet më 6 shkurt në Izmit, nga ora 17:00. Braha ka qenë më parë

shoqëruese e Delegatit Teknik në disa ndeshje kualifikuese të këtij kompeticioni. Pas një pune të suksesshme dhe vlerësimeve pozitive nga FIBA, ajo tani është emëruar në rolin e Delegates Teknike, duke shënuar një moment historik për basketbollin kosovar dhe duke u bërë kështu Delegatja e Parë Teknike e Federatës së Basketbollit të Kosovës në të dyja konkurrencat. Kjo arritje

dëshmon përkushtimin e FBK-së për të promovuar ish-basketbollistët dhe ish-basketbollistët që dëshirojnë të mbeten aktivë/e në sport edhe pas përfundimit të karrierës si lojtarë/e. Ky është një hap i rëndësishëm për basketbollin kosovar në arenën ndërkombëtare dhe një shembull i qartë i angazhimit të FBK-së për zhvillimin e profesionistëve të rinj në sport.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 05.02.2025 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike
T-25-2

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Besim Xhemajli
E-mail: besim.xhemajli@trepcasha.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

- Qëllimi i ofertës:
- Dhënie me qera e hapësirave dhe objekteve
 - Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

1. Njësia Biznesore: Industria e Baterive

Njësia Biznesore: Industria e Baterive							
Nr	Objekti	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Zyre 1	5.64	11.88	67	12.06	6.03	73.03
2	Zyre 2	11.84	11.88	140.66	25.32	12.66	153.32

2. Njësia Biznesore: Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

Njësia Biznesore: Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë							
Nr	Objekti	Sipërfaqja	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Sipërfaqe e përgjithshme	26309	0.02	526.18	94.71	47.36	573.54
2	Objekti me sipërfaqe	420	0.75	315	56.7	28.35	343.35

Kriteret e Dhënies:
Data e shpalljes:
Sqarimi:
Kërkesa për pjesëmarrje:

Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
05.02.2025
deri me 20.02.2025
Data(t) për kërkesës deri: 20.02.2025
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave:
Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
(Origjinali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit:
Vendi i dorëzimit:

20.02.2025 në 11:00
Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

- Kërkesat minimale të kualifikimit:
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
 - Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
 - Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
 - Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneks 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e vlerës së qerasë		
a	Sipërfaqja e mbuluar m²	
b	Çmimi për metër katrorë (€)	
c = b*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	

D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)	
e	Sipërfaqja e pa mbuluar m²	
f	Çmimi për metër katrorë (€)	
g = f*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	
H=e*g	Vlera e qerasë për sipërfaqen e pa mbuluar (€)	
I=D+H	Gjithsejt qeraja (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja
Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 14.05.2024 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve
Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,
Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shërbime Juridike” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810190398 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Shërbime Juridike” D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810190398 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Shërbime Juridike” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810190398 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arbër Sada nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e qendrës arsimit profesional në Pejë drejtimi Murator.
- Alush Thaqi nga Zërza KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Asllan Berisha” Rogovë KK Gjakovë.
- Arlin Beqiraj Rracaj KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u “Dy Dëshmorët” Sheremet KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ILIR Isakaj Dobidoll KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e gjimnazit “12 Maj” Ratkoc KK Rahovec.
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L